

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar  
Financial Reporting

**P5**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 21.11.2020

1. Mickey Mouse sh.a është një kompani e listuar në bursë dhe ka aksione në dy kompani të tjera, Goofy sh.a dhe Donald Duck sh.a. Pasqyrat e pozitës financiare me 31 dhjetor 2019 të të tri kompanive janë dhënë më poshtë.

<b>Pasqyrat e pozitës financiare me 31 dhjetor 2019</b>			
	<b>Mickey Mouse sha</b>	<b>Goofy sh.a</b>	<b>Donald Duck sh.a</b>
	<b>€ milion</b>	<b>€ milion</b>	<b>€ milion</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>			
Prona, fabrika & paisjet	600	800	200
Investimet	<u>1,200</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
	1,800	800	200
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>			
Stoqet	250	150	50
Të arkëtueshmet tregtare	200	100	30
Paraja & banka	<u>20</u>	<u>30</u>	<u>20</u>
	<u>470</u>	<u>280</u>	<u>100</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>2,270</b>	<b>1,080</b>	<b>300</b>
<i>Ekuiteti:</i>			
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	1,000	400	100
Fitimet e mbajtura	<u>1,090</u>	<u>510</u>	<u>150</u>
	2,090	910	250
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>			
Të pagueshmet tregtare	160	150	40
Tatimi	<u>20</u>	<u>20</u>	<u>10</u>
	<u>180</u>	<u>170</u>	<u>50</u>
<b>Total ekuiteti &amp; detyrimet</b>	<b>2,270</b>	<b>1,080</b>	<b>300</b>

**Informatat në vijim janë të rëndësishme dhe duhet të mirren parasysh:**

- (i) Mickey Mouse sh.a bleu 320 milion aksione të zakonshme në Goofy sh.a me 1 janar 2019, kur fitimet e mbajtura ishin €200 milion. Konsiderata e blerjes ishte €800 milion në para.
- (ii) Është politikë e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas vlerës së plotë (të drejtë) në datën e blerjes. Në datën e blerjes vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në Goofy sh.a ishte €100 milion.
- (iii) Me 1 janar 2019, disa paisje të mbajtura nga Goofy sh.a kishin vlerë të drejtë prej €25 milion mbi vlerën e tyre bartëse. Këto paisje në atë datë kishin jetë të mbetur të përdorimit prej 5 viteve.
- (iv) Mickey Mouse sh.a bleu 30% të aksioneve të zakonshme të Donald Duck sh.a me 1 janar 2019, kur fitimet e mbajtura të Donald Duck sh.a ishin €75 milion. Konsiderata e blerjes ishte €400 milion në para. Mickey Mouse sh.a ushtron ndikimin domethënës mbi Donald Duck sh.a.

- (v) Gjatë vitit financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2019, Goofy sh.a shiti mallra tek Mickey Mouse sh.a për €30 milion. Këto mallra janë shitur me një kosto plus marzha prej 100%. Nga këto mallra 40% janë ende në stoqet e Mickey Mouse sh.a me 31 dhjetor 2019. €10 milion e kësaj shume është ende e papaguar nga Mickey Mouse sh.a tek Goofy sh.a me 31 dhjetor 2019.
- (vi) Nuk është paguar e as nuk është propozuar ndonjë dividendë në të tri kompanitë mësipër.
- (vii) Me 31 dhjetor 2019 është kryer një test i dëmtimit të zerit të mirë dhe rezultoi që zëri i mirë është dëmtuar për 60% të vlerës së saj në blerje. Investimi në Donald Duck sh.a është dëmtuar për €50m.

**Shënim: Rrubullakëso të gjithë numrat në €0.1m më të përafërt.**

**Kërkohet:**

**Përgatite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Mickey Mouse sh.a me 31 dhjetor 2019 në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. (20 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 1

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2019

Grupi Mickey Mouse sh.a

€ milion

### *Pasuritë jo-qarkulluese:*

Prona, fabrika & paisjet (600 + 800 + 25 (VD) - 5(zhvl shtesë) (L12)	1,420
Zëri i mirë (L11)	110
Investimet në shoqëri (L13)	<u>372.5</u>
	1,902.5

### *Pasuritë qarkulluese:*

Stoqet (250 + 150 - FPR 6) (L14)	394
Të arkëtueshmet tregtare (200 + 100 -10 ndërgurpore)	290
Paraja & banka (20 + 30)	<u>50</u>
	<u>634</u>

**Total pasuritë** **2,636.5**

### *Ekuiteti:*

Aksionet e zakonshme prej €1 secila	1,000
Fitimet e mbajtura (L15)	1,169.7
IJK (L16)	<u>126.8</u>
	2,296.5

### *Detyrimet afatshkurtëra:*

Të pagueshmet tregtare (160 + 150 -10 ndërgurpore)	300
Tatimi (20 +20)	<u>40</u>
	<u>340</u>

**Total ekuiteti & detyrimet** **2,636.5**

## **Llogaritjet**

### **1. Zëri i mirë**

€ milion

Konsiderata e paguar	800
IJK Vlera e drejtë	<u>100</u>
	900

### Vlera e drejtë e neto pasurive:

Aksionet e zakonshme	(400)
Fitimet e mbajtura	(200)
Korigjim i vlerës së drejtë	<u>(25)</u>
	<u>(625)</u>

Zëri i mirë në blerje 275

Dëmtimi (275 x 60%) (165)

**2. Prona, fabrika & paisjet**

Zhvlerësimi shtesë = 25 m/5 vite = 5m

(600 + 800 + 25 (VD) - 5(zhvl shtesë) = 1,420 m

**3. Investimi në shoqëri****€ milion**

Kosto e investimit	400
Pjesa e grupit ne fitimet pas blerjes (150-75) x 30%	22.5
Dëmtimi	<u>(50)</u>
<b>Investimi në shoqëri</b>	<b>372.5</b>

**4. Fitimi i perealizuar**

Fitimi i perealizuar = 30 m / 200 x100 = 15 m x 40% =6 m

**5. Fitimi i mbajtur**

	Mickey Mouse sha € milion	Goofy sh.a € milion	Donald Duck sh.a € milion
Sipas pyetjes	1,090	510	150
Para blerjes		<u>(200)</u>	<u>(75)</u>
Pas blerjes		310	75
Zhvlerësimi shtesë		(5)	
Fitimi i perealizuar		<u>(6)</u>	
		299	
Qe i takon prindit (299 x 80%)	239.2		
Shoqeria (75 x 30%)	22.5		
Zëri i mirë (165 x 80%)	(132)		
Dëmtimi shoqërisë	<u>(50)</u>		
<b>Fitimi i mbajtur</b>	<b>1,169.7</b>		

**6. Interesi jo kontrollues****€ milion**

IJK në fillim	100
Pjesa e fitimit (299 x 0.2%)	59.8
Dëmtimi (165 x 0.2)	<u>(33)</u>
<b>IJK në fund</b>	<b>126.8</b>

2.

a) Simba sh.a, një shitës i veturave, shiti një veturë tek një klient me 14 nëntor 2018. Kontrata ishte për një cmim të dakorduar prej €30,000 dhe data e dërgimit ishte 3 janar 2019. Klienti pagoi një deposit të pakthyeshëm prej 20% me 14 nëntor 2018. Vetura u dërgua me 10 janar 2019 dhe shuma e mbetur prej €24,000 është paguar nga klienti në po atë datë.

**Kërkohet:**

**Këshillo duke treguar hyrjet përkatëse në ditar se si transaksioni i mësipërm duhet të njihet në pasqyrat financiare të Simba sh.a-së për vitin e ëprfunduar me 31 dhjetor 2018 dhe 2019? (5 pikë)**

b) Me 1 tetor 2017, Woody sh.a aplikoi tek një agjencion qeveritar për një grant si ndihmë për ndërtimin e një fabrike. Kosto e propozuar e ndërtimit të fabrikës ishte €52 milion dhe kompania parashikoi që 350 punëtor do të punësoheshin pas përfundimit. Toka ishte në pronesi të Woody sh.a-së. Me 1 dhjetor 2017, agjencioni qeveritar ofroi një grabt prej 25% të kostos së ndërtimit të fabrikës deri në maksimum €13 milion. Grantit do të paguhej në përfudimin e ndërtimit të fabrikës, dhe do të ripaguhej menjëhere nëse punësimi në fabrikë do të ishte nën 300 punëtor deri në 5 vite pas përfundimit.

Në fund të vitit financiar me 31 dhjetor 2017, Woody sh.a kishte pranuar ofertën e grantit dhe nënshkroi kontratën e ndërtimit të fabrikës prej €52 milion. Punët e ndërtimit do të fillonin me 1 janar 2018.

Deri me 31 dhjetor 2018, fabrika u ndërtua sipas buxhetimit, 400 punëtor ishin punësuar dhe aktivitetet e prodhimit ishin të gatshme për të filluar, si dhe agjencioni qeveritar u pajtua që kushtet për pagesën e grantit ishin përmbushur.

Me 1 janar 2019, fabrika është vënë në përdorim. Është vlerësuar se do të ketë jetë të dobishme ekonomike prej 10 viteve. Me 1 mars 2019, agjencioni qeveritar pagoi €13 milion siç ishte dakorduar. Përveç kësaj, kompani kërkoi dhe i është paguar një grant për punësim prej €1.2 milion pasi që punësimi tejkaloi projeksionet fillestare. Kjo pritet të paguhet në baza vjetore për 5 vite në total, me një norme prej €12,000 për çdo person më shumë se 300 në secilin vit. Nuk ka kërkesa për ripagim lidhur me këtë grant. Drejtorët e Woody sh.a-së presin që niveli i punësimit të tejkaloj 350 punëtor edhe për të paktën 4 vite të tjera pas 31 dhjetor 2019.

**Kërkohet:**

**Trego, duke i paraqitur llogaritjet dhe hyrjet përkatëse, se si Woody sh.a duhet të regjistroj transaksionin dhe ngjarjet më sipër në pasqyrat financiare për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2017, 2018 and 2019. (10 pikë)**

c) Cinderella sh.a bleu një obligacion 6% €50 milion me 1 janar 2019 me një zbritje prej 10% të vlerës nominale. Shpenzimet e blerjes ishin €500,000. Obligacioni maturon me 31 dhjetor 2028 në shumën nominale. Norma e interest vjetor efektiv deri në maturitet është 7.3%. Cinderella sh.a ka për qëllim të mbajë obligacionin deri në maturitet.

**Kërkohet:**

**Në pajtim me SNRF 9 *Instrumentet financiare*, si duhet të kontabilizohet obligacioni i mësipërm në pasqyrat financiare të Cinderella sh.a-së për vitin e ëprfunduar me 31 dhjetor 2019. (5 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 2

a) Asnjë e hyrë nuk njohet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 lidhur me këtë transaksion. Shuma prej €6,000 e pranuar në nëntor 2018 i debitohet parasë, dhe i kreditohet të hyrave të shtyera. Paraqitet si detyrim afatshkurtër në pasqyrën e pozitës financiare me 31 dhjetor 2018.

Hyrjet në ditar 2018:

D Paraja	€6,000	
K Të hyrat e shtyera		€6,000

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, të hyrat prej €30,000 duhet të njihen. Hyrja në ditar do të jetë si në vijim:

D Paraja	€24,000	
D Të hyrat e shtyera	€6,000	
K Të hyrat		€30,000

b)

### Viti i përfunduar me 31 dhjetor 2017:

Nuk ka hyrje kontabël në këtë vit financiar, pasi që nuk është hyre në transaksion. Ekziston një zotim kapital, dhe duhet të shpaloset në shënime. Aprovimi i grantit duhet të shpaloset gjithashtu.

### Viti i përfunduar me 31 dhjetor 2018:

Në këtë datë, fabrika duhet të regjistrohet sipas koston prej €52 milion. Pasi që të gjitha kushtet për pagesën e grantit janë përmbushur, njohja e kësaj shume të arkëtueshme duhet të bëhet gjithashtu. Pasi që fabrika ende nuk është vënë në përdorim nuk ngarkohet zhvlerësim për vitin. Ngjajshëm as e hyra e shtyrë nga granti nuk njohet si e hyrë.

Njohja e fabrikës:

D Prona, fabrika & paisjet	€52 milion	
K Paraja		€52 milion
(Fabrika e ndërtuar me kosto prej €52 milion)		

Njohja e grantit:

Opcioni 1

D Granti qeveritar i arkëtueshëm (pasuri qarkulluese)	€13 milion	
K Prona, fabrika & paisjet		€13 milion
(Granti qeveritar i aprovuar, por ende i paarkëtuar)		

Opcioni 2

D Granti qeveritar i arkëtueshëm (pasuri qarkulluese)	€13 milion	
K Të hyrat e shtyera – detyrim afatshkurtër		€1.3 milion
K Të hyrat e shtyera – detyrim afatgjatë		€11.7 milion
(Granti qeveritar i aprovuar, por ende i paarkëtuar)		

Duke supozuar që fabrika ka një jetë të përdorimit prej 10 viteve, siç është vlerësuar, 10% e shumës do të njihet si e hyrë në vitin e ardhshëm financiar. Kjo shume duhet të trajtohet si detyrim afatshkurtër.

#### **Viti i përfunduar me 31 dhjetor 2019:**

Ka një numër të transaksioneve për tu regjistruar duke u bazuar në fabrikën e re. Këto janë (1) zhvlerësimi dhe (2) amortizimi i grantit. Përveç kesaj, paraja është pranuar nga agjencioni qeveritar.

Pranimi i grantit:

D Paraja	€13 milion	
K Granti qeveritar i arkëtueshëm		€13 milion

(Arkëtimi i parasë nga agjencioni qeveritar)

Opcioni 1

Zhvlerësimi i fabrikës:

D Fitim ose humbje	€3.9 milion	
K Zhvlerësimi i akumuluar - PFP		€3.9 milion

(Zhvlerësimi i kostos së fabrikës neto nga shuma e granti përgjatë 10 viteve)

Opcioni 2

Zhvlerësimi i fabrikës:

D Fitim ose humbje	€5.2 milion	
K Zhvlerësimi i akumuluar - PFP		€5.2 milion

(Zhvlerësimi i kostos bruto të fabrikës përgjatë 10 viteve)

Amortizimi i grantit:

D Të hyrat e shtyera	€1.3 milion	
K Fitim ose humbje		€1.3 milion

(Amortizimi i grantit përgjatë 10 viteve, duke reflektuar pjesën proporcionale të kostos së fabrikës për të cilën është dhënë granti). Granti i punësimit ka të bëjë komplet me koston e punësimit në atë vit.

Andaj entiteti duhet të njohë komplet shumen si të hyrë në vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019.

Njohja e grantit të punësimit:

D Paraja	€1.2 milion	
K Fitim ose humbje		€1.2 milion

(njohja e grantit të punësimit si e hyrë)



c)

Vlera bartëse në fillim e obligacionit është si në vijim:	€m
Çmimi i blerjes (90% e €50)	45
Plus: kosto e blerjes	<u>0.5</u>
Total kosto e pasurisë që do të njihet	45.5
Të hyrat financiare do të njihen me 7.3% të vlerës fillestare bartëse	3.32

Pasuria financiare matet sias kostos së amortizuar

Pasuria në fillim	Të hyrat nga interesi (7.3%)	Interesi i arkëtuar (6%)	Pasuria në fund
€'m	€'m	€'m	€'m
45.5	3.3215	(3)	45.8215

**Ekstrat i fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019**

	<b>€'m</b>
<b>Të hyrat nga interesi</b>	<b>3.3215</b>

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2019 ekstrakt**

	<b>€'m</b>
<b>Pasuri financiare</b>	<b>45.8215</b>

Obligacioni i përmbush kriteret për klasifikim për matje sipas kostos së amortizuar të cilat janë:

- Pasuri mbahen brenda një modeli të biznesit, objektiv i të cilit është të mbajë pasurinë me qëllim të arkëtimit të rrjedhave kontraktuale të parasë.
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare shkaktojnë në datat e specifikuara rrjedha monetare të cilat janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe të interesit për shumën e papaguar të kryegjësë.

### 3.

(a) SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe Gabimet* vendos kriteret për përzgjedhjen e politikave të kontabilitetit dhe përshkruan rrethanat në të cilat një entitet mund të ndryshoj politikën e kontabilitetit. Standardi gjithashtu merret me trajtimin e ndryshimeve në politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe korigjimin e gabimeve të përiudhave të mëhershme.

#### Kërkohet:

- (i) Përkufizo një politikë të kontabilitetit sipas SNK 8. Shpjego shkurtimisht dallimin ndërmjet një politike të kontabilitetit dhe një vlerësimi kontabël. (4 pikë)
- (ii) Trego trajtimin në kontabilitet për të regjistruar (1) një ndryshim në politikën e kontabilitetit, (2) një ndryshim në vlerësimin kontabël dhe (3) korigjimin e një gabimi. (6 pikë)

(b) Në vijim janë përmbledhjet e draft pasqyrave financiare të WALL-E sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 se bashku me informatat krahasuese të vitit 2018. Gjatë dhjetorit 2019, para se të nënshkruheshin pasqyrat financiare, është zbuluar se një mashtrim ka ndodhur në kompani gjatë tri veteve të mëhershme.

Zyrtari kryesor financiar kishte përvetësuar paratë e paguara për kompaninë nga klientët e saj, shumat mbesi ende si të arkëtueshme. Efekti i mashtrimit ishte që shumat e treguara në pasqyrat financiare si të arkëtueshme duhet të shlyhen pasi ato ishin paguar në të vërtetë. Nuk ka asnjë perspektivë për të rikuperuar paratë pasi punonjësi i humbi ato duke luajtur bixhoz dhe tani është i falimentuar. Shumat ishin si më poshtë për secilën periudhë që mbaron në datat vijuese:

31 dhjetor 2017: €14,000

31 dhjetor 2018: €16,000

31 dhjetor 2019: €20,000.

#### **Pasqyrat e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor:**

	2019	2018
	€'000	€'000
Të hyrat	300	275
Kosto e shitjes	<u>(225)</u>	<u>(212)</u>
Fitimi bruto	75	63
Shpenzimet	<u>(30)</u>	<u>(26)</u>
Fitimi për vitin	45	37

#### **Pasqyrat e Ndryshimeve në Ekuitet (vetëm Fitimet e Ruajtura) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor:**

	2019	2018
	€'000	€'000
Saldo 1 janar	258	236
Fitimi për vitin	45	37
Dividenda e deklaruar	<u>(16)</u>	<u>(15)</u>
Saldo 31 dhjetor	287	258

**Pasqyrat e Pozitës Financiare më 31 dhjetor:**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Pasuritë jo-qarkulluese	294	306
Neto pasuritë qarkulluese	<u>143</u>	<u>102</u>
	437	408
Kapitali aksionar	150	150
Fitimet e mbajtura	<u>287</u>	<u>258</u>
	437	408

**Kërkohet:**

**Riparaqitni pasqyrat financiare të mësipërme, duke përfshirë informatat krahasuese, duke përfshirë rregullimet që ju i shihni të nevojshme si rezultat i mashtrimit. Injoroni efektin e tatimit. Shënimet shpjeguese nuk kërkohen. (10 pikë)**

### Zgjidhja e problemit 3

(a)

(i) Përkufizimi i një politike të kontabilitetit:

Politikat e kontabilitetit janë parime specifike, baza, konventa, rregulla dhe praktika të aplikuara nga një entitet në përgatitjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare.

Kur një SNK/SNRF (ose një Interpretim) aplikohet në mënyrë specifike në një transaksion, ngjarje apo rrethanëm politika ose politikat e kontabilitetit që alikohen tek ai zë duhet të përcaktohet duke aplikuar Standardin ose Interpretimin dhe duke marrë në konsideratë çfarëdo udhëzimi të implementimit të publikuar nga BNSK për atë Standard apo Interpretim.

Një entitet duhet të zgjedh dhe aplikoj politikat e tij në mënyrë konsistente për transaksione të ngjajshme, ngjarje tjera ose rrethana, përveç nëse një standard ose Interpretim në mënyrë specifike kërkon ose lejon ndryshe.

Përdorimi i vlerësimeve të arsyeshme është një pjesë esenciale e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe nuk e ulë besueshmërinë e tyre. Shembuj përfshijnë: borxhet e këqija, vjetërsimi i stokeve, vlera e drejtë e pasurive, detyrimet për garancione. Një ndryshim në vlerësimin kontabël është korigjimi i shumës së një pasurie ose detyrimi, ose shuma periodike e konsumimit të pasurisë, që rezulton nga një vlerësim i statusit aktual të përfitimeve dhe obligimeve të pritura në të ardhmen që shoqërohen nga pasuritë dhe detyrimet.

(ii) Ndryshimi në politikën kontabël:

Një entitet duhet të ndryshoj një politikë në kontabilitet vetëm nëse ndryshimi:

- Kërkohet nga një Standard ose një Interpretim; ose nëse
- Rezulton në pasqyra financiare që japin informata më të besueshme dhe relevante për efektet e transaksioneve, ngjarjeve apo rrethanave tjera për pozitën financiare, performancën financiare ose rrjedhat e parasë së një entiteti.

Një entitet duhet të llogarisë një ndryshim në politikën e kontabilitetit që rezulton nga zbatimi fillestar i një Standardi ose një Interpretimi në përputhje me kërkesat specifike kalimtare, nëse ka, në atë Standard ose Interpretim. Kur kjo nuk aplikohet, entiteti do të zbatojë ndryshimin në mënyrë retrospektive. Kjo do të thotë që pasqyrat duhet të ndryshohen në mënyrë që ato të përmbajnë numrat që do të kishin qenë aty nëse politika e re do të ishte gjithnjë në fuqi. Sidoqoftë, kjo nuk do të aplloket nëse është e pazbatueshme për të përcaktuar efektet specifike të periudhës ose efektin kumulativ të ndryshimit. Zbatimi fillestar i një politike për rivlerësimin e pasurive nuk trajtohet në këtë mënyrë

*Ndryshimi i vlerësimit kontabël:*

në përputhje me rrethanat, nuk janë korigjime të gabimeve. Efekti i një ndryshimi në një vlerësim të kontabilitetit, do të njihet në mënyrë prospektive (d.m.th. nga data e ndryshimit e tutje) duke e përfshirë atë në fitim ose humbje në periudhën e ndryshimit dhe periudhat e ardhshme.

*Korigjimi i gabimeve të periudhave të mëparshme:*

Gabimet e periudhave paraardhëse janë lëshime nga, dhe keqdeklarime në pasqyrat financiare të entitetit për një ose më shumë periudha paraardhëse që vijnë nga mos përdorimi, ose keqpërdorimi i informacionit të besueshëm që:

- Ishte në dispozicion kur pasqyrat financiare për ato periudha ishin autorizuar për publikim; dhe
- Në mënyrë të arsyeshme mund të pritet që të merren dhe të merren parasysh gjatë përgatitjes dhe prezantimit të atyre pasqyrave financiare.

Shembuj të gabimeve të tilla përfshijnë efektet e gabimeve matematikore, gabimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit, mbikëqyrjet ose keqinterpretimet e fakteve dhe mashtrimet.

Me përjashtim deri në atë masë që është e përcaktuar për të përcaktuar efektet specifike të periudhës ose efektin kumulativ të gabimit, një entitet duhet të korrigjojë gabimet materiale të periudhës së mëparshme në mënyrë retrospektive në setin e parë të pasqyrave financiare të autorizuara për publikim pas zbulimit të tyre. Kjo do të thotë që pasqyrat duhet të ndryshohen në mënyrë që ato të përmbajnë numrat të cilët do të ishin prezantuar nëse gabimi nuk do të kishte ndodhur kurrë. Duhet të ndërmerren veprimet e mëposhtme:

- Rivendosni shumat krahasuese për periudhat e mëparshme të paraqitura në të cilën ndodhi gabimi; ose
- Nëse gabimi ka ndodhur para periudhës më të hershme paraprake të paraqitur, rilidhni bilancet e fillestare të pasurive, detyrimeve dhe ekuitetit për periudhën më të hershme paraprake të paraqitur.
- Korrigjo saldon fillestare në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.

Lënia jashtë ose keqdeklarimet e zërave janë materiale nëse ato, individualisht ose kolektivisht, mund të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të pasqyrave financiare.

**(b)** Efekti i mashtrimit ekzistonte në periudhat e mëparshme, megjithëse drejtorët e WALL-E sh.a nuk ishin në dijeni të tij. Prandaj, pasqyrat financiare duhet të korrigjohen në mënyrë retrospektive. Pasi që pasqyrat financiare aktuale do të tregojnë një vit krahasues, të dyja këto vite do të riparaqiten. Çdo efekt që daton para periudhës më të hershme të paraqitur do të korrigjohet përmes saldove fillestare të ekuitetit. Efektet shtesë nga mashtrimi do të raportohen përmes fitimit ose humbjes çdo vit, duke u shfaqur si shpenzime shtesë. Efektet kumulative do të shfaqen në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, përmes një reduktimi të shifrave të arkëtueshmeve tregtare dhe fitimeve të mbajtura. Saldot fillestare të ekuitetit në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet duhet të tregojnë saldon fillestare, të rregulluar nga efekti kumulativ i korigjimit. Kjo në mënyrë që përdoruesit të mund të rikonsillojnë shifrat me ato të publikuara vitin e kaluar.

**Pasqyrat e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor:**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Të hyrat	300	275
Kosto e shitjes	<u>(225)</u>	<u>(212)</u>
Fitimi bruto	75	63
Shpenzimet	<u>(50)</u>	<u>(42)</u>
Fitimi për vitin	25	21

**Pasqyrat e Ndryshimeve në Ekuitet (vetëm Fitimet e Ruajtura) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor:**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Saldo 1 janar	258	236
Korigjimet e periudhave paraprake	<u>(30)</u>	<u>(14)</u>
Saldo fillestare e korigjuar	228	222
Fitimi për vitin	25	21
Dividenda e deklaruar	<u>(16)</u>	<u>(15)</u>
Saldo 31 dhjetor	237	228

**Pasqyrat e Pozitës Financiare më 31 dhjetor:**

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Pasuritë jo-qarkulluese	294	306
Neto pasuritë qarkulluese	<u>93</u>	<u>72</u>
	387	378
Kapitali aksionar	150	150
Fitimet e mbajtura	<u>237</u>	<u>228</u>
	387	378

4. Aladdin sh.a monton pasije të telekomunikacionit dhe i shet të shitësit me shumicë dhe tek shitësit me pakicë. Koeficientët në vijim kanë të bëjnë me shifrat mesatare të industrisë së Aladdin sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019:

Kthimi në kapitalin e angazhuar	20.10%
Marzha e fitimit bruto	32%
Marzha e fitimit neto (para tatimit)	12.50%
Koeficienti i qarkullimit	1.6:1
Koeficienti i shpejtë	0.9:1
Periudha e qarkullimit të stoqeve	46 ditë
Periudha e mbledhjes të arkëtueshmeve tregtare	45 ditë
Koeficienti borxh/ ekuitet	40%
Fitimi i dividendës	6%
Mbulimi i dividendës	3 herë

Pasqyrat financiare të Aladdin sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 janë:

<b>Pasqyra e Fitimit ose Humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019</b>	<b>€'000</b>
Shitjet	48,500
Kosto e shitjes	<u>(37,400)</u>
Fitimi bruto	11,100
Shpenzimet operative	<u>(6,880)</u>
Fitimi operativ	4,220
Kosto financiare	<u>(500)</u>
Fitimi para tatimit	3,720
Tatimi	<u>(1,800)</u>
Fitimi pas tatimit	1,920
<b>Pasqura e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2019</b>	<b>€'000</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet	10,800
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet	5,500
Të arkëtueshmet tregtare	<u>6,400</u>
	<u>11,900</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>22,700</b>
<i>Ekuiteti</i>	
Aksione të zakonshme prej €0.25 secila	3,000
Fitimet e mbajtura	<u>3,700</u>
	6,700
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
8% obligacion	6,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Mbitërheqja bankare	1,300
Të pagueshmet tregtare	7,000
Tatimi	1,700
	<u>10,000</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>22,700</b>

**Ekstrakt i Pasqyrës së Ndryshimeve në Ekuitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019**

	<b>€'000</b>
Firimet e mbajtura me 1 janar 2019	3,580
Neto fitimi pas tatimit	<u>1,920</u>
	5,500
Dividenda	<u>(1,800)</u>
Firimet e mbajtura me 31 dhjetor 2019	3,700

(Shënim: Çmimi i tregut të aksioneve të Aladdin përgjatë vitit ishte mesatarisht €6.00 për aksion.)

**Kërkohet:**

**a) Llogariti koeficientët e njejtë sikur të mesatares si industrisë për Aladdin sh.a. (10 pikë)**

**b) Si kontrollor financiare i Aladdin sh.a-së, shkruaj një raport për Bordin e Drejtorëve mbi analizën e performancës së Aladdin sh.a-së duke u bazuar në krahasimin me mesataret e industrisë. (10 pikë)**

**(Total: 20 pikë)**



## Zgjidhja e problemit 4

### a) Llogaritja e koeficienteve për 2019:

#### 1. Kthimi në kapitalin e angazhuar

Fitimi para interesit dhe tatimit/Kapitali i angazhuar  $\times 100$   $(4,220/12,700 \times 100) =$  33.23%

#### 2. Marzha e fitimit bruto

Fitimi bruto/ shitjet  $\times 100$   $(11,100 / 48,500 \times 100)$  22.89%

#### 3. Marzha e fitimit neto (para tatimit)

fitimit neto (para tatimit) / shitjet  $\times 100$   $(3,720 / 48,500 \times 100)$  7.67%

#### 4. Koeficienti i qarkullimit

Pasutitë qarkulluese / detyrimet afatshkurtëra  $(11,900 / 10,000)$  **1.19:1**

#### 5. Koeficienti i shpejtë

(Pasutitë qarkulluese - stoqet) / detyrimet afatshkurtëra  $(6,400 / 10,000)$  0.64:1

#### 6. Periudha e qarkullimit të stoqeve

Stoqet / kosto e shitjes  $\times 365$   $(5,500 / 37,400 \times 365)$  54 ditë

#### 7. Periudha e mbledhjes të arkëtueshmeve tregtare

Të arkëtueshmet tregtare / shitjet  $\times 365$   $(6,400 / 48,500 \times 365)$  48 ditë

#### 8. Koeficienti borxh/ ekuitet

Borxhi afatgjatë / ekuiteti i aksionarëve  $\times 100$   $(6,000 / 6,700 \times 100)$  89.55%

#### 9. Fitimi i dividendës

Dividenda për aksion / Çmimi i tregut për aksion  $(0.15/6 \times 100)$  2.5%

#### 10. Mbulimi i dividendës

Neto fitimi pas tatimit / Dividenda e paguar  $(1,920/1,800)$  1.07 here

### b) Raport për Bordin e Drejtorëve

Për: Board

Nga: Kontollori financiar

Data: 21 nëntor, 2020

Tema: Analiza e performancës financiare të Aladdin sh.a-së krahasuar me mesataren e industrisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor, 2019.

## Hyrje

Ky raport paraqet analizën financiare të performancës së Aladdin sh.a-së krahasuar me mesataret e industrisë.

## Rentabiliteti

Kthimi i kapitalit të angazhuat të Aladdin sh.a-së është mbresëlënës duke qenë më i lartë se mesatarja e industrisë. Kompania po përdor pasuritë e saj në mënyrë më efikase dhe efektive në gjenerimin e më shumë të hyrave dhe rrjedhimisht të fitimeve. Sidoqoftë, marzha e fitimit bruto dhe marzha e fitimit neto të Aladdin sh.a-së janë relativisht më të ulëta se mesatarja e industrisë. Kjo nënkupton që kompania po bën më shumë kosto në gjenerimin e të hyrave të saj

## Likuiditeti

Koeficienti i qarkullimit dhe koeficienti i shpejtë i Aladdin sh.a-së janë shumë më keq sesa mesatarja e industrisë, dhe me të vërtetë shumë më poshtë se normat e pritura. Problemet aktuale të likuiditetit shfaqen për shkak të niveleve të larta të të pagueshmeve tregtare dhe një mbitërheqje të lartë bankare. Niveli i lartë i stokeve përbën raportin e dobët të koeficientit të shpejtë dhe mund të jetë tregues i stokeve të vjetëruar më tej. Ditët e arkëtimit të të arkëtueshmeve tregtare është e arsyeshme krahasuar me mesataren e industrisë

## Leverazhi

Leverazhi i Aladdin sh.a-së është më shumë se dyfishi i nivelit të mesatares së industrisë. Kompania po bën një kthim të përgjithshëm prej 33.23% por vetëm duke paguar interes 8% në kreditë e saj. Niveli i leverzhit mund të bëhet një çështje serioze nëse Aladdin sh.a bëhet e paaftë për të mirëmbajtur kostot financiare. Kompania tashmë ka një mbitërheqje dhe aftësia për të bërë pagesa të mëtejshme interesi mund të jetë në dyshim.

## Koeficientët e investitorëve

Pavarësisht nga shifrat e arsyeshme të retabilitetit, (fitimi) rendimenti i dividendës të Aladdin është i dobët në krahasim me mesataren e sektorit. Nga ekstraktet e ndryshimeve në kapital mund të shihet se dividendët e përgjithshëm janë 1.8 milion € nga fitimi i disponueshëm për vitin prej vetëm 1.92 milion €, pra mbulesa e dividendës është shumë e ulët, krahasuar me mesataren e industrisë.

## Konkluzion

Kompania krahasohet në mënyrë të favorshme me shifrat mesatare të industrisë për rentabilitetin, megjithatë pozita e likuiditetit dhe leverazhit financiar i kompanisë është mjaft e dobët dhe jep arsye për shqetësim.

5.

a) Nemo sh.a është një kompani prodhuese dhe e shitje me pakicë e cila përgatit pasqyra financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar deri më 31 dhjetor të çdo vit.

Për të gjeneruar ose përmirësuar shitjet në një prej produkteve të saj më të vjetër, Nemo sh.a ofroi një promovim me emrin 'diçka falas'. Promovimi përfshinte shërbime mirëmbajtje falas për dy vitet e para. Më 1 tetor 2019, nën ofertën promovuese, Nemo sh.a shiti mallra në një zinxhir supermarketesh për €4.4 milion. Një kontratë dy vjeçare e mirëmbajtjes normalisht do të shitej për €0.5 milion, dhe çmimi sipas listës së produktit normalisht do të ishte €5 milion. Transaksioni është përfshirë në të hyrat nga shitja €4.4 milion.

**Kërkohet:**

Në përputhje me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientw*, arsyetoni trajtimin e duhur kontabël për transaksionin e mësipërm në pasqyrat financiare të Nemo për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019. (10 pikë)

b) Përkufizoni 'ekuitetin' dhe shpjegoni pse korniza konceptuale nuk përshkruan ndonjë kriter njohjeje për ekuitetin. (5 pikë)

c) Më 1 janar 2019 Moana sh.a, valuta funksionale e të cilit është euro, bleu një pronë në Dhërmi për ALL40 milion. Prona kishte një jetë ekonomike të dobishme 20-vjeçare pa vlerësuar vlerën e mbetur. Me 31 dhjetor 2019, prona u rivlerësua në ALL 45 milion'

Kurset e këmbimit ishin:

1 qershor 2018 €1 = ALL 1.32

1 janar 2019 €1 = ALL 1.25

31 dhjetor 2019 €1 = ALL 1.125

ALL është leku shqiptar

**Kërkohet:**

Në pajtim me SNK 21 *Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit* dhe SNK 16 *Prona, fabrika & paisjet* sa është shuma që duhet të njihet në Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019? (5 pikë)

## Zgjidhja e problemit 5

a) Sipas (SNRF 15), secili përbërës duhet të matet veçmas. Pasi që janë siguruar vetëm tre muaj të shërbimit të mirëmbajtjes, ne duhet të njohim vetëm 3/24 e tarifës së mirëmbajtjes si të hyra nga shitja në vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Pjesa e mbetur duhet të trajtohet si e hyrë e shtyrë dhe të njihet ndërsa shërbimi po ofrohet.

Sidoqoftë, shitja e mallrave duhet të njihet menjëherë. Meqenëse totali i vlerave të drejta tejkalon çmimin e përgjithshëm të kontratës, është dhënë një zbritje.

Meqenëse nuk e dimë se çfarë është ofruar me zbritje, do të duket e arsyeshme të zbatohet e njëjta përqindje e zbritjes për secilin komponent të veçantë.

Zbritja është 20% bazuar në çmimet sipas listës (pra  $[4.4m / (5m + 0.5m)] - 1$ ).

	€m
Shitja e mallrave (€5m x 80%)	4
Shitja e shërbimeve (3/24 x €0.5m x 80%)	<u>0.05</u>
Të hyrat që duhet të njihen në fund të vitit 31 dhjetor 2019	4.05

Të hyrat e shtyra duhet të maten me €0.35m (21/24 x €0.5m x 80%).

Të hyrat (fitimet e mbajtura duhet të zvogëlohen me €0.35m).

	€m	€m
D fitimet e mbajtura	0.35	
K Të hyrat e shtyra		0.35

b) Korniza konceptuale përkufizon ekuitetin 'interesi i mbetur në pasuritë e entitetit pasi të zbriten të gjitha detyrimet e tij'.

Ekuiteti nuk mund të identifikohet në mënyrë të pavarur nga elementët e tjerë në pasqyrën e pozitës financiare. Karakteristikat e ekuitetit janë se ekuiteti është një mbetje, d.m.th diçka e mbetur pasi entiteti e ka përcaktuar pasuritë dhe detyrimet e tij.

Me fjalë të tjera: Ekuiteti = Pasuritë - Detyrimet.

Nuk ka nevojë për kritere të njohjes së ekuitetit pasi është një mbetje, e përcaktuar pasi kriteret e njohjes të zbatohen për elementët e tjerë. Me fjalë të tjera, njohja e pasurive dhe detyrimeve do të çojë në njohjen e ekuitetit.

c) Sipas SNK 21, një pasuri e blerë në valutë të huaj përkthehet në valutën funksionale të entitetit në datën e blerjes ose rivlerësimit dhe nuk riparaqitet. Prandaj këtu ka dy lëvizje.

Kosto e pronës: ALL40 milion / 1.25 = €32 milion

Zhvlerësimi për vitin: €32 milion / 20 vite = €1.6 milion (ngarkuar tek fitimi ose humbja)

Vlera bartëse në fund të vitit: €30.4 milion

Shuma e rivlerësuar: ALL 45 milion / 1.125 = €40 milion

Përfitimi nga rivlerësimi: (40m - 30.4m) = €9.6 million (kredituar tek TTGJ)